



KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

V E N D I M

Nr. 39, datë 11.04.2016

M B I

CAKTIMIN E STRUKTURËS PËRGJEGJËSE PËR ADMINISTRIMIN E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Këshilli i Lartë i Drejtësisë i mbledhur më datë 11.04.2016, mbështetur në Kushtetutën e Republikës, në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe në Vendimin nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të Kuvendit të Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të caktojë Drejtorinë e Administratës dhe Financës pranë administratës së Këshillit të Drejtësisë si strukturë përgjegjëse për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit të gjyqtarëve në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.
2. Anëtarët e Këshillit, z. Vagjel Kosta, z. Ridvan Hado dhe z. Neritan Cena, ngarkohen për të mbikqyrur dhe monitoruar të gjithë procesin e parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, me qëllim evidentimin e përmbushjes në mënyrë të plotë të detyrimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË TË DREJTËSISË

KRYETARI


BUJAR NISHANI

